

PROPOZIM

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1 pika 8 dhe neni 36, paragrafi 1 nga Ligji për vetqeverisjen lokale („Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, nr 61/04,96/04,67/07,156/09 dhe 47/11/) dhe neni 162, paragrafi 2 nga Ligji për arsimin e mesëm (Gz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, nr.103/08,33/10,116/10,156/10,18/11,51/11 dhe 6/12,100/12,24/13,41/14,116/14,135/14), Këshilli i Komunës së Kërçovës, në mbledhjen e __ mbajtur më dt. __. __.2025, e solli këtë:

RR E G U L L O R E

Për metodologjinë e përcatimit të kriterëve për ndarjen e bllok dotacioneve destinuar për shkollat e mesme të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

Neni 1

Me këtë Rregullore, përshkruhet metodologjia për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e bllok dotacioneve, destinuar për shkollat e mesme të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës.

Neni 2

Me mjetet nga bllok dotacionet për financimin e veprimtarisë – arsimit i mesëm, të transferuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë të shpërndara në Programin N2 dhe nënprogramin N20 – arsimit i mesëm, bëhet financim i shkollave të mesme të komunës “ Drita” dhe “Mirko Mileski”.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, do të shpërndahen në veçanti për secilën shkollë të mesme në bazë të të dhënave të dorëzuara paraprake nga ana e shkollave fillore si dhe planeve të tyre vjetore financiare.

Neni 3

Shuma e bruto rrogave të cilat janë llogaritur paraprakisht dhe janë dhënë si detyrë e obloguar sipas numrit të të punësuarëve, janë tërhequr nga kjo metodologji dhe paguhen për secilën shkollë sipas llogarive të dorëzuara për rrogat.

Në rast se një punëtor, nga shkollë e caktuar, shkon në pension dhe ai vend pune nuk plotësohet me punësim të ri mjetet në sasi të bruto rrogës për atë vend pune, në bazë të ekonomicitetit do të shpërndahen në atë shkollë si mjete shtesë në planifikimin e shpenzimeve rrjedhëse.

Me eliminimin e shumës së përgjithshme të bruto rrogës nga të gjitha shkollat nga shuma e bllok dotacionit vjetorë mjetet e mbetura do të shpërndahen tek shfrytëzuesit buxhetor në përputhje me kriterët e caktuar, kështu që gjatë realizimit të planeve vjetore mund të shfrytëzohet dhe llogaria qëllimore 734014039893715.

Neni 4

Shpërndarja e bllok dotacioneve në shpenzimet rrjedhëse sipas shkollave të mesme të komunës në shkollat e mesme të komunës në rajonin e Komunës së Kërçovës, do të bëhet në bazë të kriterëve si vijon:

- numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollë (Nr.Nx)

-numri i nxënësve të cilët shfrytëzojnë transport pa pagesë(Nr.Nx.Tr)

- borxhi për shkollë (Bo.Sh.)

Konformë këtyre kritereve dhe formula

$$Nx=((Nr.Nx/Gj.Nr.Nx*100)+(Nr.Nx.Tr/Gj.Nr.Nx.Tr*100)+(Bo.Sh./Gj.Bo.Sh*100)/3$$

Eshtë caktuar shpërndarja si vijon me përqindje

SHMK	Përqindja
“Drita	60.3 %
“Mirko Mileski”	39.7 %

Neni 5

Mjetet nga bllok dotacionet deri te shkollat e mesme të komunës në Rajonin e Komunës së Kërçovës, do të drejtohen nëpërmjet Sektorit për çështje financiare të Komunës së Kërçovës cdo muaj, përkatësisht pas transferimit të tyre nga na ae Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e radhës nga dita e publikimit në “Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës”, ndërsa do të zbatohet nga dt. 01.01 deri .31.12-2026.

Nr. _____

Data __.__.2025

K ë r ç o v ë

KRYETARI I KËSHILLIT TË
KOMUNËS SË KËRÇOVËS

